



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 29 nëntor 2013
Nr.ref.:RK508/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI183/13

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegji të Ankesave të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
DHPGJS. nr. AC-II-12-0212, të 7 marsit 2013
dhe
kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), përfaqësuar nga z. Agron Kajtazi, jurist.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. AC-II-12-0008, të 23 majit 2013 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së) dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 503/2005, i 5 nëntorit 2007. Aktgjykimin e KADHPGJS-së, parashtruesi e ka pranuar më 17 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, nr. AC-II-12-0008, të 23 majit 2013, përkritazi me shkeljet e pretenduara të nenit 102.3 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt Gjyqësor] të KEDNJ-së.
4. Ndër të tjera, parashtruesi kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme.

Baza juridike

5. Neni 113.7 në lidhje me nenin 21 të Kushtetutës, neni 27 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); rregulli 55, rregulli 56 (2) dhe (3) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 24 tetor 2013, parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Postën e Kosovës.
7. Më 28 tetor 2013, kërkesa e parashtruesit arriti në Gjykatë, përmes korrierit të Postës së Kosovës.
8. Më 31 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me vendimin nr. GJR.183/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe me Vendimin nr. KSH.183/13, emëroi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga anëtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 2 tetor 2013, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 14 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 8 prill 2005, paditësit, z. B. M. dhe znj. B. M., parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, përkritazi me anulimin e kontratave të shitblerjes së

paluajtshmerive (nr. 96/62, të 13 janarit 1962, nr. 3243163, të 28 dhjetorit 1963, nr. 3022/63, të 5 shkurtit 1963), të lidhura ndërmjet paraardhësit të paditëseve dhe të paditurve.

12. Më 5 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, mori Aktgjykimin C. nr. 503/2005), me të cilin aprovoi si të bazuar padinë e paditëseve dhe obligoi të paditurën, ndërmarrjen NSH. KBI "Kosova Export", nga Fushë-Kosova që t'ua kthejë paditësve pronësinë mbi paluajtshmërinë e kërkuar.
13. Aktgjykimi i është dorëzuar së paditurës më 12 nëntor 2007, e cila nuk kishte parashtruar ankesë.
14. Më 2 prill 2008, Agjencia Kadastrale e Kosovës me Aktvendimin Nr. 952/4, refuzoi kërkesën e paditëseve për bartjen e parcelave të pretenduara. Paditësit e kishin bërë kërkesën për bartjen e atyre parcelave në pronësi të tyre në bazë të rastit të fituar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës, C. nr. 503/2005, të 5 nëntorit 2007. Kërkesa e paditësve ishte refuzuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, për shkak të pretendimit të Agjencisë se, "kërkesës i mungonin dëshmitë relevante me të cilat do të arsyetohej baza juridike e kërkesës së paditësve".
15. Më 8 qershor 2008, paditësit, kundër aktvendimit për refuzimin e bartjes së parcelave në pronësi të tyre parashtruan ankesë pranë DHPGJS-së.
16. Më 9 qershor 2010, Trupi gjykues i DHPGJS-së mori Aktvendimin SCC-08-0168, me të cilin refuzoi padinë e paditësve si të papranueshme, për faktin se përkitazi me objektin e padisë tashmë ishte vendosur me aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës. Aktvendimi në fjalë u pranua nga përfaqësuesi i paditësve dhe nga e paditura, më 18 qershor 2010.
17. Më 1 shkurt 2012, parashtruesi, si përfaqësues i NSH. KBI "Kosova Export" nga Fushë-Kosova, kundër Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 503/2005, të 5 nëntorit 2007, parashtroi ankesë pranë Kolegjit të ankesave të DHPGJ-së, me të cilën kërkoi anulimin e aktgjykimit në fjalë, për shkak të mungesës së juridiksionit primar të asaj gjykate që të vendoste për rastin.
18. Më 31 qershor 2013, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-II-12-0008, hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e parashtruesit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 503/2005, të 5 nëntorit 2007, për shkak të parashtrimin të saj jashtë afatit ligjor.
19. Në vijim, konkluzioni i Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, përkitazi me arsyetimin e aktvendimit: *"Andaj ankesa e AKP-se është e papranueshme, sepse Aktgjykimi i kundërshtuar kishte marre formën e prerë dhe ishte në procedurën përmbarimore, gjegjësisht, një atakim i tillë ka qenë i mundur vetëm me mjete të jashtëzakonshme dhe brenda afateve të caktuara ligjore."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, Aktvendimi i Kolegjit të Ankesave i DHPGJS-së me nr. AC-II-12-0008, i 23 majit 2013, me të cilin është hedhur poshtë ankesa e AKP-së si e papranueshme dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 503/2005, i 5 nëntorit 2007, përmbajnë shkelje si në vijim:

i) Shkelje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të përcaktuar me kapitullin VII, nenit 102, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit.

ii) Shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (KEDNJ), nenit 6, me të cilën parashihet gjykim i drejte dhe i paanshëm; dhe

AKP-ja shprehe qëndrimin se, Kolegji i Ankesave i DHPGJS, aktvendimin nr. AC-II-12-0008, e ka marrë duke shkaktuar shkelje të nenit 102 paragrafit 3, bazuar në faktin se, arsyetimi ligjor nuk është i bazuar në argumente ligjore, dhe arsyetimi nuk është i mjaftueshëm dhe bindës. Këtë fakt e vërtetojmë me dëshmi relevante, të cilat e vërtetojnë të kundërtën e asaj që kishte deklaruar Kolegji i Ankesave, se ankesa e AKP-se si ishte e parashtruar jashtë afatit kohor dhe si të tilla duhet të hedhet poshtë (ankesa) si e papranueshme”.

21. Për më tepër, parashtruesi, nga Gjykata Kushtetuese, kërkon që të marrë aktgjykim, me të cilin do ta shpallë kërkesën të pranueshme, si dhe të anulojë aktvendimin AC-11-12-0008, të 23 majit 2013, të lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, dhe e Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 503/2005, të 5 nëntorit 2007.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

23. Kërkesa e parashtruesit bazohet në nenin 113. paragrafi 7 të Kushtetutës, që parasheh:

113.7 “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Dhe në nenin 21. paragrafi 4 të Kushtetutës, që parasheh:

21.4 “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

24. Për qëllime të pranueshmërisë, në rastin konkret, Gjykata, i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, që përcakton se:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 muajve...”

25. Për më tepër rregulli 36 (1) pika b) [Kriteret e Pranueshmërisë] i Rregullores së punës parasheh që:

b) “kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi”

26. Nga shkresat e lëndës, vërehet qartë se vendimi përfundimtar për çështjen e parashtruesit është Aktvendimi i Kolegjit të Ankesave i DHPGJS-së, AC-U-12-0008, i 23 majit 2013, të cilin parashtruesi pohon se e ka pranuar më 17 qershor 2013.
27. Parashtruesi, më 24 tetor 2013, e kishte dorëzuar kërkesën në njërën prej filialeve të Postës së Kosovës, të cilën Gjykata e pranoi më 28 tetor 2013. Në këtë rast, data (dita) e dorëzimit të kërkesës do të merret 24 tetori 2013, data kur kërkesa është dorëzuar në filialen e Postës së Kosovës.
28. Me qëllim të llogaritjes së afatit, Gjykata i referohet dispozitave të rregullit 27. (3) dhe (6) [Llogaritja e periudhës kohore] të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 27

“Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetute, në Ligj dhe në këtë Rregullore të punës, llogaritet si me poshtë:

[...]

3) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e datës së njëjte kalendarike të muajit me ditën gjate të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;

[...]

(6) Ndryshe “nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë feste zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj”.

29. Në këtë kontest, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që ta parashtrojë kërkesën e tij brenda afatit (4) mujor, sepse kërkesa është dashur që të dorëzohej përfundimisht ditën e enjte, më 17 tetor 2013, në mënyrë që të ishte në pajtueshmëri me afatin katër mujor të paraparë me Ligj.

Sa i përket kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme

30. Gjykata vëren se, parashtruesi, gjithashtu, kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme”*.
32. Gjykata, gjithashtu, merr në konsideratë nenin 27 të Ligjit, i cili parasheh:
- “Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik”*.
33. Për më tepër, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, parasheh:
- “Në gfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjithur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme”*.
34. Së fundi, rregulli 55 (1) i Rregullores së punës thotë:
- “Kërkesa për masë të përkohshme do të shqyrtohet me shpejtësi nga Gjykata dhe do t'i jepet përparësi para të gjitha kërkesave të tjera”*.
35. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masë të përkohshme, duhet që, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, të gjejë se:
- “(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
- (b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe*
- (c) masa e përkohshme është me interes publik.*
- Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”*.
36. Gjykata konstaton se, përderisa kërkesa e parashtruesit hidhet poshtë si e papranueshme, atëherë kërkesa për masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit, prandaj kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme duhet të refuzohet.
37. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, për shkak të dorëzimit të së njëjtës jashtë afatit kohor të paraparë më Ligj dhe me Rregullore të punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 27 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b), rregullin 55, dhe rregullin 56 (2) dhe (3) të Rregullores së punës, më 14 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani